



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 18/10/2023
Nr. 5/3615

Komisioni për licencimin e BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5 me nr. protokolli 3472 të datës 02.10.2023 të parashtruar nga BPrAL - kolegji "AAB" për licencim / rilicencim, mori këtë :

V E N D I M

1. Bartësi Privat i Arsimit të Lartë "AAB" në kampusin kryesor licençohet dhe rilicençohet për programet e studimit për periudhën tre (3) vjeçare, sipas vendimeve të AKA-s. programet si në vijim:
 - 1.1 Dizajn Grafik Bachelor Profesional sipas vendimit të AKA, Ref. nr.1015, datë: 26.07.2023
 - 1.2 Menaxhment BA, sipas vendimit të AKA, Ref. nr.1202, datë: 15.09.2023
 - 1.3 Infermieri BSC, sipas vendimit të AKA, Ref. nr.1204, datë: 15.09.2023
2. Për periudhën pesë (5) vjeçare në kampusin kryesor rilicençohen programet e studimit, sipas vendimeve të AKA-s.
 - 2.1 Manaxhment MA, sipas vendimit të AKA, Ref. nr.1015, datë: 26.07.2023
 - 2.1 Gjuhë Angleze MA, sipas vendimit të AKA, Ref. nr.1201, datë: 15.09.2023
3. Bartësi Privat i Arsimit të Lartë Kolegji "AAB" dega në Gjakovë, licençohet për programin e studimit për periudhën tre (3) vjeçare, sipas vendimeve të AKA-s.
 - 3.1 Programim Bachelor Professional, sipas vendimit të AKA, Ref. nr.1016, datë: 26.07.2023
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 5, me nr. protokoll 3472 të datës 02.10.2023, të parashtruar nga kolegji “AAB”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim dhe rilicencim.

Kohëzgjatja e zhvillimit të veprimtarisë së programeve të akredituara është specifikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi

Komisioni për licencim i MASHTI, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSH;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit



Burim Gashi